



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, nenin 64.2 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, bazuar në Ftesën e datës 30.09.2022 nga IFES, si dhe Vendimin e KQZ-së Nr.01/1136/2022, i datës 04.10.2022, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me datën 28.10.2022, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Vendimit Nr.01/1136/2022, i datës 04.10.2022, për Miratimin e Pjesëmarrjes së KQZ-së në Takimin e Grupit Nën Rajonal të Rrjetit të Jurisprudencës Zgjedhore të Europës dhe Eurazisë

- I. Ndryshohet dhe plotësohet pika III e vendimit Nr.01/1136/2022, i datës 04.10.2022, për miratimin e pjesëmarrjes së KQZ-së në takimin e grupit nën rajonal të rrjetit të jurisprudencës zgjedhore të Europës dhe Eurazisë.
- II. Në pikën III nën pikën 2 të vendimit, z. Arianit Elshani zëvendësohet me z.Ibrahim Selmonaj.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, të ndërmarrë procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 28.10.2022

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kreshnik Radonij





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 pika c, të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 5, 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, KI45/2020 dhe KI46/20, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 28.10.2022, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Znj. Albana Ajvazi**, emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Kamenicë, nga subjekti politik "Partia Social Demokrate", duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal znj. Albina Mahmuti.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet znj. Albana Ajvazi, dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 21.10.2022, Nr.09/1-1249/2022, për zëvendësimin e anëtares të Kuvendit Komunal znj. Albina Mahmuti, e cila ka dhënë dorëheqje, për arsye personal.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidati në listën e rirenditur është znj. Albana Ajvazi.

Kandidatja e radhës ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit, nga i njëjti subjekt politik, e gjinisë së njëjtë, me numër më të madh të votave, duke mos tejkaluar kuotën prej 30 %, të kufirit minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2021. Andaj, pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 28.10.2022

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

